



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 48, datë 06.07.2016

**Për**

**MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTIT "FUQIZIMI I GRAVE DHE NXITJA E SIPËRMARRJES", HARTUAR SIPAS UDHËZUESIT OPERACIONAL PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "FUQIZIMI I GRAVE DHE NXITJA E SIPËRMARRJES", NË BASHKËPUNIM ME UN WOMEN ALBANIA".**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 6, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 30.12.2015, për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016" (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit "Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes" me qëllim fuqizimin dhe nxitjen e grave sipërmarrëse dhe zbatimin e projektit sipas Udhëzuesit Operacional për Zbatimin e Projektit "Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes", bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca 1.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga fondi për Projektin "Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes", Aparati i Bashkisë në programin e Kujdesit Social dhe Solidaritetit, parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2016 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**